# NUK ËSHTË NEVOJA
# TË ECIM NE RRUGE TË PASHKELURA

NGA XHAVIT SHALA

**Interviste për gazetën "Zëri i Popullit"**[1]

**Gazeta "Zëri i Popullit":** Zoti Shala, a ka ardhur koha për ngritjen e një Instituti Studimesh Antikrim?

**Xhavit Shala:** Pavarësisht se si mund te quhet apo emërtohet, ka ardhur koha qe një institucion i tille te ngrihet e te nise nga funksionimi. Realiteti qe po përballojmë kushtëzon edhe angazhimin intelektual apo profesional te njerëzve te shquar, te cilët duhet te japin kontributin dhe eksperiencën e tyre ne luftën kundër krimit. Kjo eksperience duhet t'i shërbeje parandalimit te veprimtarisë kriminale ne tërësi dhe figurave te veçanta te krimit, kryesisht te perspektives se tij.

Është e nevojshme qe veprimtaria profesionale antikrim te vendoset plotësisht ne baza shkencore, element i rendesishem i se cilës është dhe krijimi i Institutit te posaçëm kundër krimit. Natyrisht qe lufta kundër krimit nuk është thjesht një dëshire e mire dhe një fjale goje. Te luftohet krimi e kryesisht ai i organizuar, duhet qe te kemi te plotësuar një varg elementesh profesional. Ndërkohe, krijimi i institutit ne fjale është vetëm hapi i pare për ngritjen e themeleve baze për një lufte te institucionalizuar kundër krimit.

Për këtë, gjykoj se nuk është nevoja te ecim ne "rruge te pashkelura", pasi përvoja e vendeve te tjera rreth nesh apo me gjere nuk mungon, përkundrazi është shume e pasur. Mbi këtë baze mendoj se do te ishte me interes ta studionim këtë përvoje, për te marre prej saj çka është me e domosdoshme për kushtet tona konkrete.

Ngritja e një institucioni te tille do te krijonte terren te përshtatshëm për mjaft ide interesante te eksperteve kriminologe, juriste, sociologe, historiane, shkencëtare etj, ide te cilat do te përbenin edhe bazën e nevojshme te studimeve te ardhshme për luftën cilësore kundër krimit ne tërësi e atij te organizuar ne veçanti.

Këto ide fare mire mund te servireshin për strukturat shtetërore apo legjislativin shqiptar, me synimin e përmirësimeve te herëpashershme te dispozitave ligjore antikrim. Ka ardhur koha qe lufta kundër krimit te mos zhvillohet partizançe,por mbi baza shkencore. Një gjë te tille do ta favorizoje edhe ngritja e institutit te posaçëm kundër krimit.

---

[1] Intervista është botuar ne Gazetën "Zëri i Popullit" date 28.11.1999

